



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullën Zgjedhore Nr.04/2013, Votimi i Personave me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 13.10.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Rekomandimit për Rritjen e Ekipeve Mobile për Raundin e Dytë Zgjedhjeve për Kryetar Komune 2021

- I. Miratohet Rekomandimi i Këshillit për Operacione Zgjedhore për rritjen e ekipeve mobile për Raundin e Dytë të zgjedhjeve për Kryetar Komune, që do të mbahen më 14 nëntor 2021,
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Rekomandimi si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 13.10.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Data/Datum 12.11.2021

Për/Za Këshillin për Operacione Zgjedhore / Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Permes/Preko Burim Ahmetaj, Kryshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së

Nga/Od Nexhmedin Hyseni, Drejtor i Departamentit të Koordinimit në Terren

Kopje/Kopija Arkivës / KKZ-ve

Lënda/Predmet **Rekomandim për rritjen e numrit të Ekipeve Mobile për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 14.11.2021**

Të nderuar Anëtar,

Bazuar në vendimin e KQZ-së nr.2976-2021 të datës 05.11.2021 për zgjatjen e afatit për regjistrimin e votuesve me nevoja dhe rrethana të veçanta. Pra, bëhet fjalë për vazhdimin e afatit të regjistrimit për kategorinë e parë të VPNV-ve (Votuesit e ngujuar në shtëpi – votuesi që për shkak të paaftësisë fizike, shëndetësore ose çfarë do paaftësie tjetër nuk mund të votojnë në vendvotimin ku janë caktuar).

Pra, sipas këtij vendimi, afati i fundit për regjistrimin e kësaj kategorie të votuesve ka qenë data 9 nëntor 2021, ku pas kësaj periudhe është rritur dhe numri i votuesve që kanë aplikuar neper zyrat e KKZ-ve, ku si rrjedhojë e kësaj, me qellim të mbulueshmërisë me ekipe të mjaftueshme mobile në mënyrë efektive dhe për t'ju ofruar mundësi votimi për të gjithë votuesit e kësaj kategorie që janë regjistruar përgjatë kësaj periudhe, kërkohet nga KZ dhe KQZ të miraton kërkesën e KKZ-ve sipas komunave dhe ekipeve të tyre si në vijim:

- KKZ- Podujevë dy (2) ekipe mobile shtesë,
- KKZ- Dragash një (1) ekip mobil shtesë,
- KKZ- Shtime, dy (2) ekipe mobile shtesë, dhe
- KKZ- Malishevë, një (1) ekip mobil shtesë.

Me respekt!